

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	IPK suspendon zyrtarin policor që dyshohet se rrahu në stacion policor njërin nga të përfshirët në incidentin e Besart Ahmetit
ADRESA	https://lajmi.net/ipk-suspendon-zyrtarin-policor-qe-dyshohet-se-rrahu-ne-stacion-policor-njerin-nga-te-perfshiret-ne-incidentin-e-besart-ahmetit/
BURIMI	lajmi.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	7 shtator 2026, 22:52:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	7 shtator 2026, 07:53:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4d366955d3dbba861ad728ca65a2b3d902227ddd5b412a0f19e910d55075674
TEKSTI	7120b715ad068c7dd534c5149aa01e2de9dd4cd530a5da1726c518f4b3b19990
PAMJA	b975a62f00cee0f55cc77b2f69f62af68c577d839965e90b702734dc4a776315

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c1764b9d2ba7eb9571952d11208b52f900850a7caf2e4006dfd92305cfc7b253
E MËPARSHMJA	547774c4e4f65cf7c47ef5e7dc7bceb448ce209a31c819b64c1613b35a1e57b5
RRËNJA MERKLE	a42b88253b0c340fa02f24259d251e6e75ce4082f988432cb85d4a7dbcc5f14a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c1764b9d2ba7eb9571952d11208b52f900850a7caf2e4006dfd92305cfc7b253>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

Seanca konstituive më 9 shtator, në rend dite zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit...

Kërko...

lajmi.net

- [Ballina](#)
- [Lajme](#)
 - [Politikë](#)
 - [Nacionale](#)
 - [Rajoni](#)
 - [Ekonomi](#)
 - [Sociale](#)
- [VIDEO](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)
 - [Serie A](#)
 - [Premier League](#)
 - [Liga e Kombeve](#)
 - [Liga e Kampionëve](#)
 - [La Liga](#)
 - [Bundesliga](#)
 - [Copa America](#)
 - [Basketboll](#)
 - [Superliga e Kosovës](#)
 - [Të tjera](#)
- [Opinion](#)
 - [Op-Ed](#)
- [ShowBiz](#)
 - [MIRAGE](#)
 - [Kulturë/Arte](#)
- [Lifestyle](#)
 - [Shëndeti](#)
 - [Fit](#)
 - [Familja](#)
 - [Receta](#)
- [Auto & Tek](#)
 - [Auto](#)
 - [Teknologji](#)
 - [Kriptovalutat](#)
- [Fun](#)
 - [Argëtim](#)
 - [Kuriozitete](#)
 - [Rrjetet Sociale](#)
- [English](#)
 - [Hollywood](#)

lajmi.net

Seanca konstituive më 9 shtator, në rend dite zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit...

IPK suspendon zyrtarin policor që dyshohet se rrahu në stacion policor njërin nga të përfshirët në incidentin e Besart Ahmetit



Lajme

07/09/2026 09:53

Një incident u raportua të ketë ndodhur dje në parkingun e PrishtinaMall. Bëhet fjalë për një përleshje ku i përfshirë ishte edhe një zyrtar policor (kapiteni Besart Ahmeti).

Në lidhje me këtë, Inspektorati Policor i Kosovës deklaroi se është njoftuar në lidhje me incidentin i ndodhur në orët e pasdites, në parkingun e qendrës tregtare Prishtina Mall, ku ishin të përfshirë një zyrtar policor jashtë detyrës zyrtare (me gradën e kapitenit) si dhe dy qytetarë, njëri prej të cilëve i mitur.

Pas njoftimit për rastin, hetuesit e IPK-së kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe kanë dalë në vendin e ngjarjes, me qëllim të verifikimit të rrethanave dhe mbledhjes së informacioneve fillestare lidhur me incidentin.

Sipas të dhënave fillestare, incidenti dyshohet se ka nisur pas një mosmarrëveshjeje lidhur me parkingun, ndërsa personat e përfshirë më pas janë shoqëruar në objektin policor për trajtimin e rastit.

Me këtë rast theksohet se gjatë trajtimit të këtij rasti, në IPK janë ngritur pretendime për tejkalim të autorizimeve policore nga një zyrtar tjetër policor ndaj njërit prej qytetarëve të përfshirë në incident.

“Bazuar në informacionet fillestare të pranuar nga hetuesit e IPK-së, njëri nga personat e përfshirë ka pretenduar se pas shoqërimit në polici, ndaj tij është përdorur forcë nga një zyrtar policor në stacionin policor të Graçanicës. Lidhur me këto pretendime, hetuesit e IPK-së kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me prokurorin kompetent dhe, nën drejtimin e tij, kanë ndërmarrë dhe janë duke ndërmarrë veprime hetimore për ndriçimin e plotë të të gjitha rrethanave të rastit”thotë në njoftim.

Po ashtu bëhet e ditur se në kuadër të hetimit, zyrtari policor i dyshuar për keqtrajtim është suspenduar me rekomandim të IPK-së ndërsa hetimet janë duke u zhvilluar në drejtim të veprës penale “Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike”.

Hetimet ndaj qytetarëve të përfshirë do të vazhdojnë të ndërmerren nga Policia e Kosovës në konsultim të vazhdueshëm me prokurorin kompetent në drejtim të veprës penale të sulmit kurse ndaj zyrtarit policor (me gradën e kapitenit) veprimet hetimore do të ndërmerren nga hetuesit e IPK-së me dyshimin për veprën penale të kanosjes.

“IPK thekson se hetimi është në fazën fillestare dhe se të gjitha veprimet hetimore po zhvillohen në koordinim me prokurorin kompetent, duke respektuar procedurat ligjore, të drejtat e të gjitha palëve të përfshira dhe parimin e prezumimit të pafajësisë.”/T.lajmi.net/

Artikuj të ngjashëm



September 8, 2026

[Lladrovci pret kampionen e Evropës në futbollin amerikan, Edona Lekun](#)



September 8, 2026

[Kosova vendos detyrim shtesë për importin e farës së grurit nga Serbia](#)



September 8, 2026

[Pesë të arrestuar për tjetërsimin e një prone 2-hektarëshe në Fushë...](#)



September 8, 2026

[Seanca konstituive më 9 shtator, në rend dite zgjedhja e kryetarit...](#)



September 8, 2026

[Spanja sekuestron mbi 1,2 ton kokainë të fshehur në një ngarkesë...](#)



September 8, 2026

[Vetëm edhe dy ditë, mund të përfitoni nga ofertat Back to School në iCore](#)

Lajme të fundit



[Lladrovci pret kampionen e Evropës në futbollin amerikan, Edona Lekun](#)



[Kosova vendos detyrim shtesë për importin e farës së grurit nga Serbia](#)



[Pesë të arrestuar për tjetërsimin e një prone...](#)



[Seanca konstituive më 9 shtator, në rend dite...](#)

lajmi.net

Tel: +383 49 131 131

Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyra nr. 5

Rrjetet Sociale

Other Links

[Fact-Checking Policy](#)

[Ethics Policy](#)

[Corrections Policy](#)

[Ownership & Funding Information](#)

[Editorial Team Information](#)

©Copyright lajmi.net 2022. All Rights Reserved [Privacy Policy](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.